

VENDIM
Nr. 479, datë 1.9.2025

**PËR NGARKIMIN E DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERITARE PËR
PARAQITJEN E KËRKESAVE PËR KRYERJEN E PUNIMEVE DHE NDJEKJEN E
ZBATIMIT TË MARRËVESHJES PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË
RIKONSTRUKSIONIT DHE RIKONCEPTIMIT TË SALLËS SË MBLEDHJEVE
DHE HOLLIT TË SAJ NË MJEDISËT E KRYEMINISTRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare për paraqitjen e kërkesave për kryerjen e punimeve, sipas legjislacionit në fuqi, dhe ndjekjen e zbatimit të marrëveshjes së dhurimit, me objekt realizimin e projektit të rikonstruksionit dhe rikonceptimit të sallës së mbledhjeve dhe hollit të saj në mjediset e Kryeministrisë.

2. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, në funksion të zbatimit të projektit dhe të marrëveshjes së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ngarkohet për kryerjen e procedurave përzgjedhëse për mbikëqyrjen dhe kolaudimin, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Kryeministria për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku